

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Duki Glass PVC” Sh.p.k.

Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901 , dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” i ndryshuar ;
- “Statuti” është Statuti i Shoqërisë;

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, më 18/04/2024, unë si themelues, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin
“Duki Glass PVC” Sh.p.k
- (2) Themelues i shoqërisë është:
Durmish Shishko, emri i nenes Ikbali, emri i babait Shani, me shtetesi në Kosovare, lindur me 02/01/1980, lindur në qytetin Prizren, në Republiken e Kosovës, dhe banues në Rruga Sheh Emini, Nr. 9, Prizren, Kosovë, me nr. Personal 2002772577, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 2: Objekti i veprimtarisë.

- (1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin: Import-Export, prodhim i dyerve e dritareve plastike dhe alumini.

Neni 3: Kohëzgjatja

- (1) Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e papërcaktuar; pa afat.

Neni 4: Selia, Nr. i kontaktit dhe Adresa Elektronike

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga e Dibrës, Kompleksi TB 1, Nr. 22**
- (2) Nr kontakti: 0689297111
- (3) Email: dukiglasspvc@gmail.com

KREU II

KAPITALI THEMELTAR

Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë.
- (2) Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme :
 1. Ortaku themelues:
Lloji i kontributit: Para
Vlera e kontributit: 100.000 (njëqind mijë) lekë;
Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë: 100% = 1 kuotë.
- (3) Pagesat e kontributeve në para do të kryhen në llogarinë bankare të shoqërisë pas regjistrimit të Shoqerisë në QKB.

Neni 6: Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

- (1) Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) Shitblerjes;
 - c) Trashëgimisë;
 - d) Dhurimit;
 - e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj;
- (2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- (3) Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës, bazuar ne Nenin 73, pika 2 e Ligjit.

Neni 7: Zmadhimi dhe zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- (1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqerisë duke rritur kuotën e ortakut ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithëshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
- (2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- (3) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.
- (4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8: Organi Vendimmarres

- (1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- (2) Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- (3) Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- (4) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 9: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Administratori/ët thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe me kërkesën e ortakëve sipas Nenit 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- (2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi dërguar me postë ose postë elektronike (email) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dergohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë perpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- (3) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime te vlefshme vetëm nese te gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarsisht parregullsisë.

Neni 10: Kuorumi

- (1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime te vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- (2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë

vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

- (3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendor me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11: Marrja e vendimeve

- (1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- (2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve;
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Neni 12: Votat e ortakëve

- (1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- (2) Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do t'i komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të janë të vlefshme.

Neni 13: Votimi me prokurë

- (1) Ortaku, në pamundësi të tij, ka të drejtë të emerofjë një Përfaqësues për të votuar në emër të tij në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë dhe në çdo mbledhje të shtyrë.
- (2) Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose nje kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë ose në nje vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyre, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.
- (3) Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (email) sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vone se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.
- (4) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 14: Përjashtimi nga e drejta e votës

- (1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- (2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

KREU IV ADMINISTRATORI

Neni 15: Emërimi i Administratorëve

- (1) Asambleja e përgjithshme mund të emëronjë një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërise. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit por prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të Ligjit, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshti, me këto dispozita eshtë i pavlefshëm.
- (3) Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formen e autorizimit ose me prokurë. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjetër, i cili emërohet me Asambleja e Ortakeve.
- (4) Personi i mëposhtëm caktohet Administratori i shoqërisë:

Emri: Durmish Shishko

NID: 2002772577

Neni 16: Kompetencat e Administratorit

- (1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqerinë tregtare;
 - c) kujdesen përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruanjë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpëra asamblesë së përgjithshme përmiratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përmiratim, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmes Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- (2) Administratoret Jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjithshme, në rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- (3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- (4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 17: Pergjegjesite e Administratorit

- (1) Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- (2) Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- (3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- (4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- (5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 3 e 4 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

- (6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- u kthen ortakëve kontributet;
 - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - jep kredi.
- (7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- (8) Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 18: Përfaqësimi

- Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve i kundrejtohen palëve të treta në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit.
- Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese per shoqerinë.
- Administratoret mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosin Administratorët dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

Neni 19: Shpërblimi, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorëve

- Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Nenit 97 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose per shoqëri paraardhëse të shoqërise ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tillë.
- Administratorëve mund t'iu paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzimeve të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Administratorëve ose të komiteteveve të Administratorëve ose të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me përbushjen e detyrave të tyre.

KREU V

DIVIDENTI DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 20: Dividendët

- (1) Pas plotësimit të parashikimeve të Nenit 77 të Ligjit 9901, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- (2) Me përshtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjestim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- (3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
- (4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që të paguajë atë.

Neni 21: Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

- (1) Administratori/ët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit 9901, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

KREU VI

PRISHJA DHE RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 22: Prishja dhe Likuidimi

- (1) Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
 - a) Me vendim të asamblesë së përgjithshme;
 - b) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - c) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - d) Me vendim të gjykatës;
- (2) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- (3) Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë, duhet shenuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e sipër".

- (4) Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë janë Nenet 191 deri 203 të Ligjit 9901.
- (1) Shoqëria mund të likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 23: Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

- (1) Shoqëria mund të ndahet apo të bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24: Baza Ligjore

- (1) Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut e legjislacionit shqiptar.
- (2) Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25: Mosmarrëveshjet

- (1) Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25: Gjuha e statutit

- (1) Ky statut hartohehet dhe perditesohet ne gjuhen shqipe. Palet jane ne gjendje per ta lexuar dhe kuptuar qarte permbajtjen e tij.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut Themelues:

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "DURMIS SHISHI". The signature is written in a cursive style with some variations in letter height and thickness.